



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1079 prot.

Tiranë, më 08. 02. 2019

Lënda: Dërgohen rekomandime për projektligjin “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”.

KOMISIONIT PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Të nderuar anëtar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në ushtrim të kompetencës të parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku sanksionohet se: “*Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues*”, pasi u njoh me projektligjin “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”, relacionin shoqërues dhe raportin e vlerësimit të ndikimit, dëshiron të sjell në vëmendjen Tuaj disa çështje dhe rekomandime që paraqesin rëndësi në lidhje me këtë projekt-akt.

Projektligji “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”, ndër të tjera trajton dy aspekte të rëndësishme të mbrojtjes sociale: ndihma ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, të cilat janë dy forma të ndryshme të mbështetjes që ofrohen në kuadër të asistencën sociale sipas këtij projektligji. Një formë tjetër mbështetje në kuadër të asistencës sociale sipas këtij ligji është edhe ndihma e menjëhershme financiare për foshnjat e sapolindura (bonusi i bebes), e cila në nenin 2, të projektligjit pasqyrohet në një pikë më vete, më konkretisht germa “c”.

Këto forma të mbështetjes të ofruara në kuadër të asistencës sociale edhe pse kanë si qëllim të përbashkët të mbrojnë individët nga përjashtimi social dhe kontribuojnë në garantimin e një standarti të përshtatshëm jetese, targetojnë kategori të ndryshme individësh. Për sa më sipër, **rekomandojmë që, përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, të cilat përmenden në germën “a” të nenit 2, të projektligjit, të parashikohen në pikë të veçantë nga ndihma ekonomike. Në këtë mënyrë do të dali me qartë edhe natyra e këtyre dy formave të mbështetjes në kuadër të asistencës sociale.**

Në germën “b” të nenit 2, të projektligjit përdoren fjalët “....sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh....”. Shërbimet e kujdesit shoqëror rregullohen nga ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Sugjerojmë që ky parashikim duhet të hiqet me arsyetimin se shërbimet nuk janë objekt i rregullimit të këtij projektligji dhe se shërbimet e kujdesit shoqëror rregullohen nga ligji nr.121/2016 dhe për këtë arsy përfshirja e një parashikimi të tillë do të sillte mbivendosje dhe paqartësi.

Në nenin 4, germa “ç”, parashikohet”ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror.....”. Kjo pikë duhet të rishikohet, pasi ky projektligji nuk trajton shërbimet e kujdesit shoqëror.

Në nenin 4, të projektligjit ku trajtohen parimet ku bazohet asistenca sociale, përcaktohet mosdiskriminimi në germën “d” dhe barazia dhe mosdiskriminimi në germën “e”.

Sugjerojmë që këto dy pika të bashkohen në një pikë, duke u riformular, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me këtë përbajtje: **“Mosdiskriminimi - Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnje lloj diskriminimi çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër”**

Në nenin 5 të projektligjit jepen kuptimi që termat e përcaktuara në këtë nen, kanë sipas këtij projektligji. Në germën “h”, të këtij neni jepet përkufizimi për termin “kryefamiljar”, Kështu, referuar kësaj pike, përcaktohet se, **me termin “Kryefamiljar” kuptohet personi sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtarë më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtarë më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç. Përkufizimi i dhënë në këtë pikë është e njëjtë me përkufizimin sipas ligjit në fuqi nr. 9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, për këtë term.**

Renditja që bëhet në këtë përkufizim, duke vendosur në radhë të parë babain pastaj nënën, vendos një preferencë bazuar në gjini, ku vetëm në mungesë të babait, nëna do të konsiderohet si kryetare e familjes. Pra, mënyra se si është formuluar kjo pikë vjen në kundërshtim me parimin e barazisë, pasi përcakton një radhë preferenciale bazuar në gjini.

Parashikimi i bërë në nenin 16, pika 5, e projektligjit, sipas të cilat janë gratë ato të cilat do të marrin në dorëzim ndihmën ekonomike, për familjet në nevojë, në referim të nenit 11, të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, konsiderohen veprime pozitive, masa të përkohshme që synojnë përshtypjen e vendosjes të barazisë. Por, këto masa dhe të tjera veprime pozitive që ndërmerrin për përshtypjen e vendosjes së barazisë, janë të përkohshme dhe të kufizuara në hapësirë dhe duhet të ndërpriten apo të jetë arritur ofrimi i mundësive të barabarta.

Në nenin 5, të projektligjit, jepet përkufizimi i termave “invalid pune”, “paraplegjik”, “tetraplegjik”. Përdorimi i këtyre termave duhet të shmanget, pasi nuk janë në përputhje me standartet e Konventës “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”. Konventa kërkon që shtetet, jo vetëm që të miratojnë masa ligjore dhe administrative për të realizuar të drejtat sipas kësaj konverte, por duhet që të marrin gjithashtu masa për të për të modifikuar apo zhvlerësuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikat ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara. Është e qartë që termat e mësipërm vijnë në kundërshtim me konceptet e Konventës për aftësinë e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuar. Ligji “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë*” ka vendosur detyrimin për institucionet përgjegjëse, të cilat bazuar në këtë ligj, duhet të ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar. Në situatën e hartimit të një ligji të ri është e papranueshme që të vazhdohet të përdoren terma të cilat vijnë në kundërshtim me Konventën dhe Ligjin “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë*”. Projektligji jep gjithashtu edhe përkufizimin e termit “person me aftësi të kufizuara”, i cili është në përputhje me Ligjin “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë*”. Përdorimi njëkohësisht i këtij termi dhe termave të mësipërm që janë në kundërshtim me standartet e aftësisë së kufizuar, krijojnë gjithashtu konfuzion.

Tërësia e këtyre termave për personat me aftësi të kufizuar krijon përshtypjen se personat me aftësi të kufizuar janë një grup dhe personat sipas përkufizimeve “invalid pune”, “paraplegjik”, “tetraplegjik” janë grupe të tjera. Kjo mënyrë e të pasqyruarit të aftësisë së kufizuar vazhdon t’i shërbejë dhe të mbajë në fuqi fragmentarizimin e situatës së aftësisë së kufizuar. Një paqartësi tjetër që vjen si pasojë e fragmentarizimit të legjislacionit të aftësisë së kufizuar, është edhe fakti se personat me aftësi të kufizuara në shikim, pra personat që kanë statusin e personit të verbër, nuk përfshihen në këtë ligj. **Rekomandojmë që, të shmanget përdorimi i termave që janë në kundërshtim me standartet e aftësisë së kufizuar dhe unifikimi i të kuptuarit të personave me aftësi të kufizuar në përputhje me këto standarte.**

Në nenin 8, të projektligjit përcaktohen subjektet e aftësisë së kufizuar. Edhe ky nen vazhdon të mbajë në fuqi fragmentarizimin e personave me aftësi të kufizuara dhe krijon konfuzion duke bërë referenca tek komisionet ekzistuese të vlerësimit dhe komisionit shumëdisiplinor të aftësisë së kufizuar. Në aktet shoqëruese të projekt ligjit, prezantohet se një nga qëllimet kryesore të kësaj nisme, është të reformojë sistemin e vlerësimit të aftësisë duke vënë në zbatim sistemin e vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social. Realizimi i këtij qëllimi, por edhe detyrimi që buron nga Konventa për të kaluar në sistemin e ri të vlerësimit nuk rezulton se mund të realizohet nga mënyra se si projektligji prezanton subjektet përfituesë në nenin 8. Në vijim të këtij arsyetimi, pasqyrimi i vlerësimit bio-psiko-social në nenin 30, në pjesën e dispozitave të fundit dhe kalimtare, nuk është i përshtatshëm. **Sa më sipër, rekomandojmë që, vlerësimi bio-psiko-social nuk duhet të pasqyrohet në dispozitat e fundit dhe kalimtare, por duhet të përbëjë boshtin kryesor në projektligji për sa i takon personave me aftësi të kufizuar.** Sugjerojmë që boshllëku ligjor që mund të krijohet si rezultat i ekzistencës së disa skemave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të adresohet tek dispozitat e fundit dhe kalimtare.

Në nenin 10, të projektligji, të rishikohet referenca duke pasur parasysh rekomandimin e Komisionerit për nenin 5.


Në nenin 11, të projektligjit, ku përcaktohen subjektet që nuk përfitojnë sipas këtij ligji, në vlerësimin tonë, germa “ç” rezulton e paqartë. Kjo pikë duhet të qartësohet, por në çdo rast personat me aftësi të kufizuar nuk duhet të përjashtohen nga e drejta e pagesës së aftësisë së kufizuar.

Në nenin 12, të projektligjit, pika 6, përcaktohet se: Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune apo individ përfitues i ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve në nenin 7, të këtij ligji, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

Nga tërësia e dispozitave të këtij ligji rezulton se pagesa e aftësisë së kufizuar është një pagesë që i jepet personit me aftësi të kufizuar për të kompensuar një disavantazh si pasojë e aftësisë së kufizuar. Pagesa e aftësisë së kufizuar për këtë qëllim është parashikuar në nenin 5, germa “sh” të projektligjit, si një e ardhur që nuk llogaritet në të ardhurat totale të familjes. Pagesa e aftësisë së kufizuar nuk i nënshtronhet asnjë kriteri vlerësimi në lidhje me gjendjen ekonomike të personit me aftësi të kufizuara. Pra, kjo pagesë i jepet personit me aftësi të kufizuara pavarësisht nga gjendja e tij ekonomike. Nëse dy familje në nevojë, njëra nga të cilat ka në përbërje person/persona me aftësi të kufizuara, për të njëjtin numër anëtarësh në përbërjen e saj, familja në përbërje të të cilës ka persona me aftësi të kufizuar do të vendosen në një pozitë më pak të favorshme, në krahasim me familjen e cila për të njëjtin numër anëtarësh do të marrë një pagesë më të lartë të ndihmës ekonomike, pasi anëtarë i familjes

në nevojë i cili merr pagesën e aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në masën e ndihmës ekonomike. Në vlerësimin e Komisionerit, kjo sjell një trajtim më pak të favorshëm për shkak të aftësisë së kufizuar për familjet që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuara. Shumica e personave me aftësi të kufizuara jetojnë në kushte të varfërisë dhe është një nevojë kritike që të adresohet ndikimi negativ i varfërisë te personat me aftësi të kufizuara. Konventa “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, thekson se, duke qenë se familja është njësia e përbërë natyrale dhe themelore e shoqërisë , ka të drejtë të mbrohet nga shoqëria dhe shteti, dhe se personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e tyre të familjes duhet të marrin mbrojtjen dhe assistencën e duhur, me qëllim që të bëjnë të mundur që familjet të kontribuojnë që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të plotë dhe të barabartë. **Sa më sipër, rekomandojmë që pika 6, e nenit 12, të projektligjit të rishikohet, duke eliminuar situatën e mësipërme dhe duke hequr parashikimin se anëtarit të familjes në nevojë që është person me aftësi të kufizuara, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.**

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, besojmë në ndërhyrjen Tuaj, me qëllim reflektimin në projekt-ligj të rekomandimeve si më sipër.



Konc: Klodiana Keta (Kamberaj), Specialistë

